

PROCESVERBAL

**nga vazhdimi i parë i seancës së 18-të të Këshillit të Agjencisë për Shërbime
Mediatike Audio dhe Audiovizuale
mbajtur më 02.05.2024**

Anëtarët e pranishëm të Këshillit të Agjencisë: Lazo Petrushevski kryetar i Këshillit të ASHMA-së, Selver Ajdini zëvendës kryetar i Këshillit të ASHMA-së, mr. Alma Mashoviq, dr. Metodija Jançeski, Lazar Trajçev, Zoran Fidanoski.

Anëtarët në mungesë të Këshillit të Agjencisë: /

Në seancë ishte i pranishëm dhe dr. Zoran Trajçevski, drejtor i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale.

Të pranishëm nga Shërbimi Profesional: mr.Emilija Janevska, mr.Emilija Petreska Kamenjarova, mr.Ivona Mufisheva, dr.Ivana Stojanovska, mr.Ruzhica Boshnakoska Jotevska.

Të pranishmit e tjerë: /

Z. Petrushevski hapi vazhdimin e parë të seancës së 18-të të Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale. Seanca filloi në ora 13:00 dhe u mbajt në ambientet e Agjencisë, salla e konferencave, kati i dytë.

Z. Petrushevski njoftoi se në seancë do të shqyrtohet pika e cila ishte anuluar dhe që i referohej Raporteve tremujore për punën e Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale për periudhën nga data 1 janar deri më 31 mars 2024. Ai shpjegoi se Raportet janë të karakterit informativ dhe Këshilli nuk i voton. Në lidhje me përmbajtjen e tyre, ai tha se me të vërtetë është e dukshme puna voluminoze e Agjencisë dhe bashkëpunimi ndërkombëtar që është për lavdërim. Ai deklaroi se për të Raporti është pozitiv dhe është pasqyrë e punës reale të Agjencisë.

**Agjencia për Shërbime Mediatike
Audio dhe Audiovizuale
Kryetari i Këshillit,
Lazo PETRUSHEVSKI, d.v.**